



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

KOSOVO CENTER FOR PUBLIC SAFETY EDUCATION AND DEVELOPMENT
QENDRA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE EDUKIM DHE ZHVILLIM
KOSOVSKI CENTAR ZA JAVNU BEZBEDNOST OBRAZOVANJE I RAZVOJ

Duke u bazuar në rregulloren 2001/36, Urdhëresën administrative 2003/2 dhe Udhëzimin Administrativ 2003/1, Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim në Vushtri, zyra Personelit shpallë:

K O N K U R S

Titulli i Vendit të punës: **Shef i Zyrës Ligjore**

Raporton: **Kryeshefit Ekzekutiv**

Koeficienti: **(9) Sipas Rregullores 2001/36 mbi Shërbimin Civil**

Nr.Ref: **07/2010**

Vendi: **Vushtri**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Harmonizon materialin e shkruar të doracakëve në QKSPEZH, me ligjet në fuqi, siç janë: Kodi Penal i Kosovës, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Ligji mbi ESPK të Kosovës, Ligjin Penal për të Mitur të Kosovës, Ligji mbi Policinë, Ligji mbi Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, Ligji mbi Imunitetin dhe ligje tjera).
- Bënë harmonizimin dhe rishikimin e materies ligjore në doracakë, sipas kërkesave të Departamenteve.
- Merr pjesë në komisionin disiplinor, të ankesave dhe atë për mbikëqyrje të brendshme.
- Bashkëpunon me institucione të sistemit gjyqësor dhe institucionet tjera.
- Përfaqëson juridikisht dhe mbron interesat e QKSPEZH, pranë gjykatave dhe institucioneve tjera në Kosovë.

- Bashkëpunon me departamentet e QKSPEZH si dhe ofron përkrahje ligjore për të gjitha agjensioneve (PK, SHKK, DK, QTE).
- Ofron përkrahje profesionale dhe ligjore për të gjitha sektorët e QKSPEZH-it.
- Përpilon kontratat dhe aktet tjera nënligjore.
- Ofron përkrahje ligjore lidhur me procedurat disiplinore në QKSPEZH.

Kualifikimet edukative dhe profesionale për post:

- Përgatitje Universitare (Jurist i Diplomuar).
- 3 Vite përvojë pune (në fushën e hartimit ligjor dhe përfaqësimit në Gjykatë).
- Njohja e gjuhës Shqipe ose Serbe (në të folur dhe të shkruar).
- Njohja e gjuhës Angleze (në të folur dhe të shkruar) e dëshirueshme.
- Shkathëtit me kompjuter duke përfshirë Microsoft Word, Excel dhe Power Point-esenciale.
- Fleksibiliteti dhe aftësia për të punuar nën presion dhe Brenda kohës së caktuar, janë të nevojshme.